

**AKTI I THEMELIMIT**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**“Delvina Gas Trading” SH.P.K**

Në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar dhe Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar, sot më datë 20.06.2022, Ortakët e shoqërisë:

- **Z. Ilir Merja**, shtetas shqiptar, lindur më 16.09.1960, në Tiranë, banues në Tiranë, mbajtës i Kartës së Identitetit me Nr. Personal: G00916044M, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në cilësinë e Ortakut zotërues të 90 % (nëntëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë;

dhe

- **Z. Sami Hajderaj**, shtetas shqiptar, lindur më 26.12.1969, në Ballsh, banues në Fier, mbajtës i Pasaportës me Nr. Personal: G91226049A, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në cilësinë e Ortakut zotërues të 10 % (dhjetë përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë;

Kanë vendosur të nënshkruajë Aktin e Themelimit të mëposhtëm, për krijimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, aktiviteti i së cilës rregullohet nga Legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statuti i saj.

**NENI 1**  
**EMËRTIMI I SHOQËRISË**

- 1.1** Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është “**Delvina Gas Trading**” sh.p.k., në vijim referuar si “*Shoqëria*”.

**NENI 2**  
**BAZA LIGJORE**

- 2.1** *Shoqëria* do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” i ndryshuar dhe legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 2.2** Kjo *Shoqëri* fiton zotësinë për të vepruar me regjistrimin e saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.



### **NENI 3 SELIA**

- 3.1** Selia kryesore e aktivitetit të *Shoqërisë* është në adresën: Rruga e Elbasanit, Vila Nr.71, Njësia Administrative Nr. 2, Tiranë, Shqipëri.
- 3.2** Shoqëria mund të hapë filiale, degë përfaqësie ose agjensi në varësi të saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë në çdo kohë që çmohet e arsyeshme prej saj dhe me aprovimin e organeve kompetente.

### **NENI 4 OBJEKTI**

- 4.1** Objekti i veprimtarisë së *Shoqërisë* përfshin sa më poshtë vijon:

Tregtia e gazit, e naftës dhe e nënprodukteve të saj, për ato bio dhe lëndë djegëse, përfshirë dhe pa u limituar në shitjen me shumicë, transportimin, depozitimin, import-eksport, blerjen dhe shkëmbimin e naftës dhe nënprodukteve të saj, si dhe gazit natyror e cila mund të zhvillohet në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe/ose jashtë saj.

Ndërtimin dhe shfrytëzimin e depozitave të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre; projektim, ndërtim dhe përdorim i tubacioneve, depozitave, impianteve dhe teknologjive, me qëllim përdorimin e naftës dhe nënprodukteve të saj, djegien e gazit për prodhimin e energjisë elektrike, tregtimin e saj brenda dhe/ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Çdo aktivitet tjetër të dobishëm ose të nevojshëm për arritjen e objektit të saj ose që ka lidhje me të në kuptimin më të gjerë të fjalës.

Për të realizuar objektin e veprimtarisë së saj, shoqëria mund të veprojë brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe të kryejë çdo aktivitet tjetër të nevojshëm, të lidhur, instrumental, të dobishëm, të përafërt, elementar, etj në funksion dhe në nevojë të veprimtarisë së saj.

### **NENI 5 KOHËZGJATJA**

- 5.1** Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë është me afat të pacaktuar.

### **NENI 6 KAPITALI THEMELTAR**

- 6.1** Kapitali themeltar i *Shoqërisë* është 1.000.000 (një milion) Lekë, tërësisht i nënshkruar dhe i pashlyer nga Ortakët e *Shoqërisë*, përpara regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.





6.2 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 2 (dy) kuota.

6.3 Pjesët e kapitalit zotërohen nga Ortakët e shoqërisë, si më poshtë:

- **Z. Ilir Merja**, shtetas shqiptar, lindur më 16.09.1960, në Tiranë, banues në Tiranë, mbajtës i Kartës së Identitetit me Nr. Personal: G00916044M, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, zotëron 1 (një) kuotë me vlerë të barabartë me 900.000 (nëntëqind mijë) Lekë, e cila përfaqëson 90% (nëntëdhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë;

**dhe**

- **Z. Sami Hajderaj**, shtetas shqiptar, lindur më 26.12.1969, në Ballsh, banues në Fier, mbajtës i Pasaportës me Nr. Personal: G91226049A, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, zotëron 1 (një) kuotë me vlerë të barabartë me 100.000 (njëqind mijë) Lekë, e cila përfaqëson 10% (dhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë.

#### NENI 7

#### TRANSFERIMI I PJESËVE TË KAPITALIT THEMELTAR

- 7.1 Pjesët e kapitalit themeltar janë të transferueshme ndaj të tretëve sipas procedurave të parashikuara në Statutin e shoqërisë dhe në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", *i ndryshuar*.

#### NENI 8

#### ADMINISTRIMI

- 8.1 Emërohet si Administrator i Shoqërisë **Z. Ilir Merja**, shtetas shqiptar, lindur më 16.09.1960, në Tiranë, banues në Tiranë, mbajtës i Kartës së Identitetit me Nr. Personal: G00916044M, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
- 8.2 Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", *i ndryshuar* dhe dispozitave të Statutit të shoqërisë.
- 8.3 Administratori është i autorizuar të veprojë në emër të *Shoqërisë* në formim e sipër deri në regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, si dhe ka të drejtë t'i delegojë kompetencat e tij personave të tjerë.
- 8.4 Administratori do të qëndrojë në detyrë për 5 (pesë) vjet dhe gëzon të drejtën e riemërimit në këtë detyrë pas përfundimit të mandatit të tij.

#### NENI 9

#### DISPOZITA PËRFUNDIMTARE



9.1 Çështjet që nuk trajtohen në këtë Akt Themelimi, rregullohen në Statutin e Shoqërisë si dhe në legjislacionin shqiptar në fuqi.

9.2 Ky Akt Themelimi është hartuar në Tiranë, Shqipëri në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe, duke patur të gjitha të njëjtën fuqi ligjore.

**ORTAKËT E SHOQËRISË "Delvina Gas Trading" SH.P.K.**

**Z. ILIR MERJA**

Ilir Merja



**Z. SAMI HAJDERAJ**

Sami Hajderaj

